

VENDIM
Nr. 94, datë 4.7.2017

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 176, SERIA T12 TË SHOQËRISË “DANSKE
COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 71, datë 11.5.2017, filloi procedurën për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. ka plotësuar kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “p”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti